KËRKESË
Nr. 3990/1, datë 8.10.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkues është Bashkia e Tiranës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të rikonstruksionit të rrugëve të bllokut nr. 59, është 44 059 821.2 (dyzet e katër milionë e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e një, pikë dy) lekë, ndërsa vlera e shpronësimit të pronarëve, për rikonstruksionin e rrugëve të "bllokut 61 dhe 61/1", është 222 520 451 (dyqind e njëzet e dy milionë e pesëqind e njëzet mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri